

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI FILOLOGJIK – GJAKOVË

PROGRAMI: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

TEMA: PARAFJALA te vepra “Darka e Gabuar”e I.Kadaresë

Mentori:

Prof.asoc.dr.Xheladin Zymberaj

Kandidatja:

Agnesa Gjota

GJAKOVË, 2018

PËRMBAJTJA

Abstrakt.....3

Metodologjia.....4

Hyrje.....5

KREU I

1.1.Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.....6

1.1.1.Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.....7

1.1.2.Dallimi në mes të pjesëve të pandryshueshme dhe të ndryshueshme të ligjëratës.....8

KREU II

1.2.Pjesët e pandryshueshme dhe karakteristikat e tyre.....9

1.2.1.Ndajfolja.....12

1.2.2.Klasifikimi i ndajfoljeve.....13

1.2.3.Shkallët e ndajfoljeve.....15

1.2.4.Formimi i ndajfoljeve.....16

KREU III

1.3.Lidhëza.....17

1.3.1.Klasifikimi i lidhëzave nga prejardhja..... 18

1.3.2.Klasifikimi i lidhëzave nga pikëpamja e strukturës morfologjike.....19

1.3.3.Klasifikimi i lidhëzave nga pikëpamja sintaksore.....21

KREU IV

1.4.Pjesëza.....22

1.4.1.Klasifikimi i pjesëzave sipas strukturës.....23

1.4.2.Klasifikimi i pjesëzave sipas kuptimit.....25

KREU V

1.5.Pasthirrma.....26

1.5.1.Klasifikimi i pasthirmave.....27

1.5.2.Klasifikimi i pasthirmave sipas kuptimit.....28

KREU VI

1.6.Parafjala.....29

1.6.1.Klasifikimi i parafjalëve sipas prejardhjes.....31

1.6.2.Klasifikimi i parafjalëve sipas strukturës morfologjike.....34

1.6.3.Klasifikimi i parafjalëve sipas kriterit sintaksor.....35

Biografia e Ismail Kadaresë.....37

Shembuj me parafjalë të nxjerrë nga vepra “Darka e Gabuar e

I.Kadaresë.....39

Përfundim.....	40
Literatura.....	41
Jetëshkrim.....	42

ABSTRAKT

Objekti i punimit të diplomës sime është i mirë trajtuar por shtruarja dhe zgjidhja e problemeve në një temë të tillë për gjuhën shqipe, mbështetur në materiale të gjëra, kërkon një studim të thellë.

Gjatë shtjellimit të literaturës për zgjidhjen e problemit mbi parafjalën, kam klasifikuar dhe sistemuar materialin në mënyrë që të jetë sa më i kuptueshëm .

Nga materialet e shumta të nxjerra, nga Gramatika e gjuhës shqipe 1, do të flasim për çështjen mbi parafjalën e cila bën pjesë në pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.

METODOLOGJIA

Fillimisht jam munduar të gjej material sa më shumë, në mënyrë që të kem një trajtim sa më të gjerë dhe sa më të saktë, rreth temës që kam.

Më së shumti jam përqendruar te Gramatika e gjuhës shqipe 1, poashtu edhe te libra të tjerë të gjuhës shqipe, kam bërë përpjekje që të shtjelloj temën në mënyrën më të mirë të mundshme, të jetë sa më e kuptueshme.

HYRJE

Morfologjia¹(nga greqishtja morfe=formë dhe logos=fjalë,dije) është ajo pjesë e gramatikës,që merret në radhët e parë me studimin e trajtëformimit, d.m.th, me studimin e formave të ndryshme,që marrin fjalët e lakueshme(emrat, mbiemrat, përemrat dhe numërorët) ose të zgjedhueshme (foljet), si edhe me studimin e kuptimeve të këtyre formave.

Morfologjia pjesët e ligjëratës i ndan në dy grupe: të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Pjesët e ndryshueshme të ligjërates janë:(emir,mbiemri,përemri,numërori dhe folja), ndërsa të pandryshueshme janë:(ndajfolja,parafjala,lidhëza pjesëza dhe pasthirrma).

Kurse une te Prof.Xheladin Zymberaj për punim diplome e kam zgjedhur këtë temë:Parafjala në veprën “Darka e Gabuar” të shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare.

Puna ime e parë ka qenë që materialin i çili ndërlidhet drejtëpërdrejt me Parafjalën ta sistemoj, ta klasifikoj dhe ta parashtoj në mënyrë sa më të qelluar e të kuptueshme.

Jam munduar që të përmbledh shënime në pika të shkurtëra duke u bazuar në të dhënat e teksteve të ndryshme që i kanë dhënë gjuhëtarët më eminent shqiptarë nëpër librat e tyre.

Gjithmonë duke u konsultuar me gramatikën e gjuhës shqipe 1, dhe gramatikat e tjera ashtu siç e parashohin normat standard të gjuhës .Gjatë shpjegimit të parafjalës, për çdo të dhënë ,kam marrë shembuj konkretë, të cilët i kam hasur te vepra “ Darka e Gabuar”nga Ismail Kadare.Dhe në fund e falënderoj Prof.asoc.dr.Xheladin Zymberaj i cili ma propozoi këtë temë prej së cilës kam fituar shumë.

¹ ASHSH,IGJL,Grup autorësh,Gramatika e gjuhës shqipe 1,Tiranë 2002,fq29

KREU I

1.1. Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës

Të gjitha fjalët e një gjuhe, sipas veçorive të përbashkëta leksiko-gramatikore, grupohen nëpër kategori a klasa leksiko-gramatikore të cilat quhen pjesë të ligjëratës.²

Pjesët e ligjëratës i ndajmë në dy grupe: të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Në pjesët e ndryshueshme të ligjëratës hyjnë:**emri,mbiemri,përemri,folja,numërori.**

Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës që kanë kaluar në conversion në pjesë të pandryshueshme , janë vetëm emra e folje.Ndajshitesat e ndryshme që mund të kenë ato, pas këtij lakimi e kanë humbur plotësisht kuptimin e tyre gramatikor dhe janë bërë pjesë e pa analizueshme e temës së fjalës.³

Me anë të konverzionit formohen emra prej mbiemrash (të nyjshëm e të panyjshëm)dhe mbiemra të panyjshëm prej emrash.Duke u shndërruar në emër,mbiemri e ruan kuptimin themelor leksikor të cilësisë a të tiparit që shpreh, por kjo cilësi a tipar paraqitet si e sendëzuar, e konkretizuar: mbiemri bëhet emër i sendit që ka atë cilësi ose emri i vetë cilësisë:**e bukur, të ftohtë, e verdha (e vezës), e bardha (e vezës, e syrit), të lashtat, të ardhurat, i ri, i ve, i ditur, shtypur etje.**Krahas kthimit të mbiemrave në emra vërehet edhe procesi i kundërt, kthimi i emrave në mbiemra.Mbiemrat e formuar me këtë rrugë janë të gjithë të panyjshëm.Emri që kthehet në mbiemër, rrallëherë është fjalë e parme.P.sh:**kyç(problem kyç, çështje kyçe),plak(burrë plak, grua plakë), bullgar, frëng, ilir,turk etje.**

Shumica e emrave që mbiemërzohen janë fjalë të prejardhura me prapashtesa:**fshatar(originë fshatare),pushkatar(skuadër pushkatare),dokumentar(film dokumentar etj),etj.**

Për shkak të numrit të madh të mbiemrave të prejardhur me prapashtesa, të cilët janë emëruar, ka mjaft prapashtesa që shërbejnë për të formuar edhe emra, edhe mbiemra.

² ASHSH,Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë 2002fq36

³ ASHSH.Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë 2002.....fq.77-78

1.1.1. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës

Te fjalët shërbyese mënyrat morfologjike të fjalëformimit nuk veprojnë fare, kështu që ato janë formuar ose me përngjitje, ose me konversion. Gjithashtu me konversion janë formuar edhe një numër ndajfoljesh. Te grupi i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës dallojmë dy nëngrupe:⁴

- a) Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës që vijnë nga pjesë të pandryshueshme parafjalë prej ndajfoljesh: **afër, anës, brenda, drejtë, gjatë, jashtë, krahas, larg, matanë, para, pas, përmas, pranë, sipër, veç, etj.**

Lidhëza prej ndajfoljesh: **Ku, kur, nga, si, etj**

- b) Pjesë të pandryshueshme të ligjëratës që vijnë nga pjesë të ndryshueshme, p.sh., ndajfolje: **Vjet, mot, sheshit, hapur ndenjor etj.** Parafjalë: **buzë, rreth, mes, rrëzë etj,** lidhëza: **daç, qoftë etj,** pjesëza: **le, desh, etj,** pasthirrma: **qyqja, korba, forca, o burra etj.**

Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës që kanë kaluar në konversion në pjesë të pandryshueshme, janë vetëm emra e folje. Ndajshitesat e ndryshme që mund të kenë ato, pas këtij kalimi e kanë humbur plotësisht kuptimin e tyre gramatikor dhe janë bërë pjesë e paanalizueshme e temës së fjalës p.sh. **(ndajfolja sheshit nuk mund të ndahet në shesh-it ose sheshi-t, ajo si ndajfolje është pjesë e pazbërthueshme).**

⁴ ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë 2002... fq. 77

1.1.2. Dallimi në mes pjesëve të pandryshueshme dhe të ndryshueshme të ligjëratës

Dallimi në mes tyre është se pjesët e pandryshueshme të ligjëratës janë formuar ose me përngjitje, ose me konversion, gjithashtu me konversion janë formuar edhe një numër ndajfoljesh, ndërsa pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, me anë të konversionit janë formuar emra prej mbiemrash (të nyjshëm e të panyjshëm), dhe mbiemra të panyjshëm prej emrash.⁵

Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës janë: emri, mbiemri, përemri, folja, numërori, sepse e ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit në fjali.

Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës janë: Ndajfolja, lidhëza, pjesëza, parafjala, pasthirrma, këto nuk e ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit në fjali.

⁵ ASHSH.Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë 2002...fq.77

KREU II

1.2. Pjesët e pandryshueshme dhe karakteristikat e tyre

Ndajfolja

Ndajfolja si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës plotëson kuptimin e foljes, duke emërtuar rrethanën, cilësinë a intensitetin e veprimit dhe tregon shkallën e cilësisë së mbiemrit a të rrethanës, P.sh.: **Ai mbeti gjithmonë i dashur.**,⁶

Ndajfolja si fjalë emërtuese dallohet nga pjesët e tjera të pandryshueshme të ligjëratës, sepse në fjali përdoret si gjymtyrë me vete.

Ajo mund të përdoret në fjali në funksion të rrethanorit (nganjëherë tërë trupin ja kaplonte njëfarë gëzimi, vetëm pse e kishte gjetur atje...), të përcaktorit (zjarri e kishte kapluar tërë vendin përreth) dhe të kallëzuesorit (nëna e kishte lënë dritën ndezur).

Sa i përket fjalëformimit, ato dalin me një sistem të caktuar prapashtesash, si fjalë të prejardhura. Prapashtesat –azi, -(i)sht, -thi janë karakteristike vetëm për formimin e ndajfoljeve, si p.sh.: haptazi, fshehurazi, trimërisht, gabimisht, kalimthi, fluturimthi etj. Në këtë grup të veçantë bëjnë pjesë ndajfoljet përemrore, të cilat ashtu si përemrat nuk janë fjalë emërtuese, por treguese të tilla janë ndajfoljet: ku, kur, aty, këtu, atje, nga, si, qysh, andej, këtej, ashtu, kështu pse, përse etj.

⁶ SHLP. Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998... fq.192

1.2.1. Klasifikimi i ndajfoljeve

Në bazë të kuptimeve që shprehin dhe shërbimet që bëjnë në fjali, ndajfoljet i klasifikojmë në dy grupe: në **ndajfolje përcaktore dhe në ndajfolje rrethore**⁷.

- **Ndajfoljet përcaktore**-janë ato që emërtojnë cilësinë e veprimit, intensitetin e tij ose tregojnë shkallën e cilësisë së mbiemrit a shkallën e veprimit të rrethanës.
- **Ndajfoljet rrethore**-emërtojnë rrethana të kohës, të vendit, dhe të shkakut.

Grupi përcaktor ndahet në ndajfolje të mënyrës dhe në ndajfolje intensive (të sasisë)

a) Ndajfoljet e mënyrës shprehin mënyrën si kryhet një veprim.

Këto ndajfolje shprehin ngjyime të shumta të mënyrës së veprimit .Kështu, disa ndajfolje që përkojnë me trupin e mbiemrave mund të shprehin cilësi, ecuri a përmasa të veprimit si p.sh.:bukur, qetë, mirë, keq, qartë, pastër, rëndë, rrëmbyeshëm, gëzueshëm, mendueshëm, gjerë, thellë, ulët . ja disa shembuj të tyre në fjali: Vjollca shkruan bukur.Ajo i shqipton fjalët qartë. Punët i fillon mbar. etj.Ndajfoljet e mënyrës janë edhe lokucionet : me kujdes, me radhë, me të drejtë, më të mirë, më të keqë, më qetë, ose lokucionet e formuara nga të përsëriturit e një emri a përdorimi i dy emërave me kuptime të afërta:pjesë-pjesë, palë-palë, herë-herë, valë-valë, etj

b)Ndajfoljet intensive (të sasisë)-shërbejnë për të shprehur intensitetin e veprimit ose për të treguar shkallën e cilësisë së mbiemrit a shkallën e veprimit të rrethanës.Ndajfoljet intensive(të sasisë)jane:plot, mjaft, shumë, pak, tepër, fort, një herë, dy herë, njëfish, dy fish etj.P.sh.:Atë mëngjes oborri i shkollës ishte plot.etj⁸

Grupi rrethor ndahet në ndajfolje rrethore të kohës, të vendit dhe të shkakut.

a)Ndajfoljet rrethore të kohës emërtojnë një rrethanë kohore,d.m.th.tregojnë kohën e kryerjes së një veprimi, zgjatjen a sasinë e kohës së veprimit nga rrethanat kohore.Ato janë:sot, sont, tani për tani, menjëherë aty për at, dje, nesër, mbrëmë, verës, herët, vonë, vjet etj.

⁷ SHLP.Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakov ë 1998...fq.193,194

⁸ SHLP.Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakov ë 1998...fq.196,197

b)Ndajfoljet rrethore të vendit emërtojnë rrethana të vendit, d.m.th, tregojnë vendin kur kryhet, ku është kryer a do të kryhet një veprim a ndodh një ngjarje.Ato janë:brenda, jashtë, përpara prapa, pas, poshtë, lartë, këtu, atje, larg afër, rreth,rrrotull , kudo diku,gjékundi, gjithkund, kurkund, gjithëandej, etj.⁹

c)Ndajfoljet rrethore të shkakut njihen si të tilla tani vonë.Më tepër janë njohur si lidhëza bashkërenditëse përmbyllëse dhe lidhëza nënrënditëse shkakore ato janë:prandaj, andaj, pse, përse etj.

⁹SHLP.Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998...fq.198,199

1.2.2. Shkallët e ndajfoljeve

Kategorinë gramatikore të shkallës e kanë përgjithësisht mbiemrat cilësorë. Po këtë veçori gramatikore e kanë edhe ndajfoljet, por jo të gjitha. Ashtu si mbiemrat edhe ndajfoljet kanë tri shkallë: Pohore, krahasore dhe sipërore.¹⁰

1. Shkalla pohore e ndajfoljeve është bazë për dy shkallët e tjera

Ndajfolja në këtë shkallë nuk ka ndonjë tregues të veçantë. Ajo shprehet në formën e saj përfaqësuese. P.sh.: Agroni e filloi mirë punën. Ai punon shumë etj.

2. Shkalla krahasore e ndajfoljeve ndërtohet mbi bazën e ndajfoljeve në shkallën pohore, duke pasur parasysh gjithnjë krahasimin e dy gjymtyrëve. Ajo ndahet në shkallë krahasore të barazisë, shkalle krahasore të sipërisë dhe shkallë krahasore të ultësisë.

a) Shkalla krahasore e barazisë

Shkalla krahasore e barazisë tregon se gjymtyra e parë e krahasimit është në nivel të njëjtë me gjymtyrën e dytë edhe kjo shkallë nuk ka ndonjë tregues morfologjik që të dallohet formalisht nga ndajfolja në shkallën pohore, por, kuptohet, meqë ndërtohet mbi bazën e krahasimit të dy gjymtyrëve dhe përpara ndajfoljeve mund të vihet njëra nga ndajfoljet e sasisë aq ose kaq. P.sh.: Bardhyli i ka hyre punës (aq) mirë sa i vëllai.

b) Shkalla krahasore e sipërisë

Shkalla krahasore e sipërisë tregon se gjymtyra e parë e krahasimit është në një shkallë më të lartë se gjymtyra e dytë. Kjo shkallë ndërtohet në mënyrë analitike, duke ia paravënë ndajfoljes në shkallën pohore ndajfoljen intensive (e sasisë) më. P.sh.: Gjithqka u mor vesh më vonë. etj.

c) Shkalla krahasore e ultësisë

Shkalla krahasore e ultësisë tregon se gjymtyra e parë e krahasimit është në një shkallë më të ulët se gjymtyra e dytë. Ashtu si te mbiemri edhe te ndajfolja kjo shkallë përdoret rrallë, meqë është me burim të huaj dhe nuk i përshtatet natyrës së gjuhës sonë. Ndërtohet me shprehjet nuk a s' + folje + aq + ndajfolje. P.sh.: Nuk shkojnë punët aq mirë si mendon ti.

3. Shkalla sipërore e ndajfoljeve.

Shkalla sipërore e ndajfoljeve tregon se tipari a intensiteti i veprimit është në shkallën më të lartë, jashtë çfarido krahasimi. Ndërtohet në mënyrë analitike me ndajfoljet : shumë, tepër fort etj. P.sh.: Në bisedat e njëzve përshkruhej mjaft bukur ky qytet i çuditshëm etj.¹¹

¹⁰ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë, 1998..fq.199,200

¹¹ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë, 1998..fq.201

1.2.3. Formimi i ndajfoljeve

Mënyrat e formimit të ndajfoljeve në gjuhën shqipe janë të shumta. Mjaft ndajfolje janë formuar me anë të prapashtesimit, ndajfoljzimit të pjesëve të tjera të ligjeratës, më anë të përngjitjes si dhe ka mjaft shprehje ndajfoljore-lokucione. Për nga ndërtimi, pra ndajfoljet janë: fjalë të parme, të prejardhura, të përngjitura dhe lokucione¹².

Ndajfoljet e parme janë ato që nuk kanë dalë nga fjalë të tjera, përkatësisht tema e tyre sot (në planin sinkronik) nuk është e motivueshme. Të tilla janë ndajfoljet: shumë, tepër, mjaft, aq, kaq, afër, larg, lart, poshtë, bukur, mirë, keq, këtu, aty, kështu, ashtu, etj.

Ndajfoljet e prejardhura. Prejardhja është mënyrë mjaft prodhimtare e klasës së ndajfoljeve. Konversioni a ndajfoljzimi, që i takon më tepër tipit sintaksor të fjalëformimit, gjithashtu është prodhimtar.

Ndajfoljet prapashtesore. Prapashtesat që shërbejnë për të formuar ndajfolje janë karakteristike për këtë klasë leksiko-gramatikore. Ato janë pak sa i përket numrit të tyre. Prapashtesat e tilla janë -(i)sht, - as/azi. =thi, çe.

Me prapashtesat -(i)sht janë: lirisht, trimërisht, besnikrisht, mrekullisht, varfërisht, hollësisht, përfundimisht etj.

Me prapashtesën -as/ -azi janë: anastjelltas a anastjelltazi, fshehtas a fshehtazi, haptas a haptazi, majtas a majtazietj

Me prapashtesën -thi u shtohet zakonisht temave prodhuese emërore, te prejardhura me prapashtesën -im, si: fluturimthi, kapërcimthi, qëllimthi, nxitimthi, vetëtimthi etj.

Prapashtesa -çe është e burimit të huaj, ka prejardhje nga gjuha turke, p.sh.: çobançe, tregtarçe, qençe, fshatarçe, inatçe, gjakovarçe etj.

¹² SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998...fq..202,203

Ndajfoljet parashtesore .Parashtesimi si tip fjalëformues nuk është prodhues për ndajfoljet.Disa ndajfolje që na duken se janë formime parashtesore, ato në të vërtetë duhet të jenë ndajfolje të përngjitura, si:përballë, përbrinjë, përditë, përdhe etj.¹³

Ndajfoljzimi(konversioni).Ndajfoljzimi a konversioni është mënyra e kalimit të pjesëve të ndryshme të ligjeratës në ndajfolje, në kushte të caktuara sintaksore, pa pjesmarrjen e ndajshitesave fjalëformuese.Ndajfoljzohen : emrat, mbiemrat e emëruar si dhe pjesoret e foljeve.

Ndajfoljet e përbëra janë të pakta.Kompozimi si mënyrë fjalëformimi është joprodhues për ndajfoljet.Te keto kompozita elementet përbërësë zakonisht janë dy emra, ose emër+ndajfolje a folje si:këmbëkryq, këmbëngultas, kokëposhtë, kokulur, kryekeput etj.

Ndajfoljet lokucione.Formohen lokucione ndajfoljore zakonisht nga përsëritja e të njëjtit emër në numrin njëjës a shumës, si: palë-palë, herë-herë, valë-valë, fije-fije, grupe-grupe, togje-togje, rende-vende, shkallë-shkallë etj., nga përsëritja e të njëjtit emër që lidhet me lidhëzen këpujore e, si : varg e varg, rreth e rreth, palë e palë etj., nga lidhja e dy emrave të afërt nga kuptimi ose me kuptim antonomik, si : copë e thërrime, rreth e qark, rreth e rrotull, anë e kënd ditë e natë etj.

Nga përsëritja e të njëjtit emër nepërmjet parafjalëve për, më, me si: kokë për kokë, faqe për faqe, gushë për gushë, ditë për ditë, javë për javë, rrugë më rrugë, odë me odë, kokë më kokë, shpat më shpat,etj.,nga përsëritja e të njëjtit emër me parafjalën ndajfoljore pas, si: ditë pas dite, kohë pas kohe, herë pas here, dorë pas dore, orë pas ore, etj., nga një parafjalë dhe një emër (kryesisht emri është në rasën kallëzore të pashquar –në formë të ngurosur), si:me nxitim, me radhë, me kujdes, me shpejtësi, me vrap etj.,me parafjalën me dhe një mbiemër të emëruar të gjinisë asnjënjëse, si: me të mirë, me të keq, me të butë, me të vështirë, etj.¹⁴

¹³ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq.203,204

¹⁴ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq.205,206

KREU III

1.3. Lidhëza

Lidhëza i takon klasës së fjalëve të pandryshueshme dhe si fjalë shërbyese përdoret për të lidhur dy njësi sintaksore, përkatësisht dy gjymtyrë të fjalisë, dy fjali, duke shprehur dy marrëdhënie të shumëllojshme sintaksore në mes tyre. P.sh.: Afërditë e dashur, as ty, që më je njëkohësisht motër e vëlla bashkë, nuk ju kam shkruar të vërtetën.¹⁵

Në fragmentin e sipërm lidhëza as..as(e përsëritur) lidh një togfjalësh e një gjymtyrë fjalie, lidhëza e lidh gjymtyrë të njëllojta (homogjene) si dhe dy fjali, lidhëzat se, sikur lidhin fjali të varura me fjalitë drejtuese të tyre, ndërsa lidhëza megjithëkëtë lidh dy fjali kryesore.

Veçoria themelore e lidhëzave, pra është funksioni lidhës. Në këtë pikëpamje ato ngjajnë me përemrat lidhorë, mirpo dallohen qartë nga lidhorët, meqë ata në fjali mund të dalin në funksione të ndryshme sintaksore (si gjymtyrë fjalie). Ndërsa lidhëzat nuk e kanë këtë veçori. Lidhëzat afrohen sidomos me parafjalët. Si parafjalët ashtu edhe lidhëzat janë pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, janë fjalë me kuptim leksikor të kushtëzuar dhe që të dy klasat e fjalëve shërbejnë për të shprehur marrëdhënie sintaksore midis dy gjymtyrësh. Por midis tyre ka ndryshime. Kështu, derisa parafjalët u paraprijnë emrave, mbiemrave të emëruar, numërorëve ose përemrave në një rasë të caktuar, lidhëzat u paraprijnë pjesëve të ndryshme të ligjëratës (vihen përpara fjalëve të lakueshme në të gjitha rasat), vihen përpara njësisive sintaksore të njëllojta, por edhe të ndryshme për ti lidhur ato, duke shprehur marrëdhënie të ndryshme sintaksore.

¹⁵ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë...1998..fq.214

1.3.1. Klasifikimi i lidhëzave nga prejardhja

Nga pikëpamja e prejardhjes lidhëzat i ndajmë në dy grupe: lidhëza të parme dhe lidhëza jo të parme (të prejardhura).

-Lidhëza të parme janë ato që prej kohësh janë përdorur si lidhëza dhe nuk mund të themi se kanë dalë (sot nuk janë të zbërthyeshme) nga pjesë të tjera të ligjëratës. Të tilla janë lidhëzat e, dhe, edhe, o, po, (r), ose, apo, as (megjithëse tri të fundit historikisht nuk janë të tilla).¹⁶

-Lidhëza jo të parme janë ato që kanë dalë nga pjesë të ndryshme të ligjëratës me konversion, me anë të përngjitjes a shprehjesh lidhëzore.

a) Lidhëza me konversion nga pjesë të ndryshme të ligjëratës:

-nga ndajfoljet: ku, kur, nga, tek, veç:

-nga përemrat pyetës: sa, se:

-nga përemri lidhorë: që:

-nga foljet dua e jam: daç...daç..., qoftë...qoftë

-nga pjesëza pyetëse: a.

b) Lidhëza të përngjitura janë ato që janë formuar në gjuhën shqipe nga përngjitja e dy e më shumë fjalëve, ku si element përbërës dominues është lidhëza. P.sh.: kursë, nëse, sikurse, ngaqë, prejse, përveçse, veçse etj.

ç) Lidhëza lokucione mund të paraqiten të plota ose të ndara (të përsëritura) në dy pjesë.

Të ndara në dy pjesë lidhëzat do të quhen dyshe. Të tilla janë lidhëzat: as...as, ose...ose, ndo...ndo, si...si, daç...daç, qoftë...qoftë, jo vetëm që..., por, jo vetëm që...porse, jo që... le që..por as që etj.

Lidhëzat lokucione kanë në përbërjen e tyre mjaft trajta të ndryshme foljore, emra të ngurosur, ndajfolje e lidhëza të thjeshta etj., si p.sh.: në qoftë se, në është se, duke qenë se, potë jetë se, po qe se, për arsye se, me kusht që, në mënyrë që, me qëllim që, në rast se, për shkak se, në vend që, ashtu që, ngado që, kudo që, sado që, sido që, vetëm se, deri diku, gjer ku, edhe po, edhe pse, qysh se, sa herë që etj.

¹⁶ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998...fq.115

1.3.2. Klasifikimi i lidhëzave nga pikëpamja e strukturës morfologjike

Nga pikëpamja e strukturës morfologjike lidhëzat i ndajmë : në të thjeshta, të përngjitura, dhe lokucione.

a) Lidhëza të thjeshta janë të gjitha lidhëzat e parme, si:e, dhe, edhe, o, por, ose, as.

Lidhëzat ndajfoljore, si: ku, kur, nga, tek, veç,:lidhëzat përemrore: që, sa, se dhe lidhëza pjesëzore pyetëse:a

b)Lidhëza të përngjitura janë ato që janë formuar me përngjitjen e dy a më shumë fjalëve në një fjalë të vetme, si p.sh.: nëse, sesa, veç, se, meqë, saqë, ngaqë, prejse, sikurse, megjithëse, gjithësaherë, domethënë etj.

ç)Lidhëza lokucione janë shprehjet lidhëzore të ndërtuara nga dy e më shumë fjalë, si:nëqoftë se, së është se, duke qenë se, po qe se, në rast se, ngado që, sido që, jo vetëm që, porse, jo që, por, le që, por edhe etj.¹⁷

¹⁷ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq.216

1.3.3. Klasifikimi i lidhëzave nga pikëpamja sintaksore

Sipas funksionit sintaksor lidhëzat ndahen : në lidhëza bashkërenditëse dhe në lidhëza nënrenditëse.

- a) Lidhëzat bashkërenditëse janë ato që lidhin dy togfjalësha, dy gjymtyrë homogjene të një fjalie si dhe dy fjali të një fare (lloji).P.sh.:Erveheja në Burim dhe Marjeta në Buzë takoheshin shpeshherë me vajzat e nusët.
- b) Lidhëzat nënrenditëse janë ato që lidhin zakonisht një fjali të varur me fjalinë drejtuese(kryesore) të saj.Bëjnë përjashtim lidhëzat nënrenditëse:se, sa, si, sesa, porsì, të cilat mund të lidhin edhe gjymtyrë fjalie.P.sh.:Ditët e fundit isha i mërzhitur si ti, sepse nuk na linin më të luajmë rrugëve.¹⁸

Lidhëzat bashkërenditëse.Në bazë të kuptimit, përkatësisht marrëdhënieve që shprehin, lidhëzat bashkërenditëse ndahen në: Lidhëza këpujore, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse, dhe në ato të shkallëzimit.

1.Lidhëza këpujore janë ato që shërbejnë për të lidhur dy njësi sintaksore a dy gjymtyrë homogjene të një fjalie.Këto janë lidhëza tipike bashkërenditëse.Të tilla janë: e, dhe, edhe, si. As, as...as, si...si:..ashtu edhe.

2.Lidhëza veçuese janë ato që shërbejnë për të lidhur dy njësi sintaksore a dy gjymtyrë homogjene të një fjalie, nga të cilat njëra përjashton tjetren.Të tilla janë lidhëzat :a, o, ose, apo, ja...ja, ndo...ndo, qoftë,qoftë, daç...daç, o...a, ose...ose, etj.

3.Lidhëza kundërshtore janë ato që shërbejnë për të lidhur dy njësi sintaksore, që shprehin marrëdhënie të tilla që e kundërshtojnë në një mënyrë njëra-tjetrën.Të tilla janë lidhëzat: por, porse, mirëpo, ndërsa, veç, veçse, vetëm,vetëm se, megjithatë, megjithkëtë, etj.

4.Lidhëza përmbyllëse janë ato që, së bashku me njësinë sintaksore të cilës i paravihen,tregojnë një përfundim lidhur me një a më shumë mendime të shprehura më parë.Të tilla janë:prandaj, andaj, pra, pa etj.

5.Lidhëza të shkallëzimit janë ato lokucione lidhëzore, që lidhin njësi sintaksore, duke vendosur marrëdhënie shkallëzimi midis tyre, ku njësia e dytë zakonisht është më e theksuar se e para¹⁹.

¹⁸ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq.117

¹⁹ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq.118

Këto lidhëza në të vërtetë kanë vlerë këpujore, ndonjëherë edhe vlerë kundërshtore. Të tilla janë: jo që, por(po), jo që...por(po)edhe, jo vetëm që,...por(po), jo vetëm që,por(po)edhe, jo vetëm që...por as, le që...por as(që)etj.

Lidhëzat nënrenditëse. Në bazë të kuptimit ,përkatësisht marrëdhënive që shprehin, lidhëzat nënrenditëse ndahen në lidhëza :ftilluese,kohore,vendore,qëllimore,shkakore,kushtore,krahasore, mënyrore, lejore, rrjedhimore dhe kundërvënëse(opozicionale).²⁰

1.Lidhëza ftilluese janë ato që lidhin një fjali të varur kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore a përcaktore me fjalinë drejtuese të saj.Shprehin vetëmu marrëdhënie sintaksore varësie midis fjalish, prandaj quhen edhe lidhëza jokuptimore.Janë lidhëza ftilluese:se, që, sikur.

2.Lidhëza kohore quhen ato që shërbejnë për të ndërtuar fjali të varura kohore dhe që shprehin marrëdhënie të ndryshme kohore.Të tilla janë lidhëzat:si, sa, pasi a mbasi, posa a porsa, gjersa a derisa, ndërsa, kur, sapo, qëkurse, që kur, qysh se, kurdo që, para se, sa herë që etj.

3.Lidhëza vendore quhen ato që shërbejnë për të ndërtuar fjali të varura vendore dhe që shprehin marrëdhënie të ndryshme vendore.Të tilla janë lidhëzat:ku, nga, ngado, që, tek, tekdo që, kudo që, deri ku a gjer ku etj.

4.Lidhëza qëllimore quhen ato që përdoren për të ndërtuar fjali të varura qëllimore dhe që shprehin marrëdhënie të ndryshme qëllimore.Të tilla janë lidhëzat:që, me qëllim që, në mënyrë që.

5.Lidhëza shkakore janë ato që shërbejnë për të ndërtuar fjali të varura shkakore dhe që shprehin marrëdhënie të ndryshme shkakore.Të tilla janë lidhëzat:se, pse, sepse, si, ngase, që, ngaqë, nga shkak që, me që, meqenëse, prejse, derisa, përderisa, sapo, posa, sapo që, duke qenë se, për arsye që, për shkak se, nga shkak se etj.²¹

6.Lidhëza kushtore janë ato që shërbejnë për të ndërtuar fjali të varura kushtore, të cilat lidhen me fjalitë drejtuese për të treguar rrjedhimin e kushtit.Të tilla janë lidhëzat:në, nëse, në qoftë se, në është se, po, po që se, në rast se, më kusht që etj.

7.Lidhëza krahasore -mënyrore janë ato që shërbejnë për të lidhur fjali të varura krahasore e mënyrore me fjalitë drejtuese ose dy gjymtyrë të një fjalie, që shprehin marrëdhënie të ndryshme mënyrore a krahasore midis tyre.Të tilla janë:si a siç, se, sa, sesa, po, sa a porsa, sikur, sikurse, ashtu si(ç)etj.

²⁰ SHLP Gjuha e sotme shqipe Gjakovë 1998..fq..219

²¹ SHLP Gjuha e sotme shqipe Gjakovë 1998..fq..220

8.Lidhëza lejore janë ato që shërbejnë për të ndërtuar fjali të varura lejore, të cilat tregojnë se veprimi i shprehur në fjalinë drejtuese mund të kryhet, pavarësisht nga mungesa e disa kushteve .Të tilla janë:sado, sado që, sido që, ndonëse, edhe, edhe në, edhe po, edhe pse, edhe sepse, edhe sikur, edhe në qoftëse, megjithëse, megjithëqë etj.

9.Lidhëza rrjedhimore janë ato që përdoren për të ndërtuar fjali të varura rrjedhimore, që shprehin shkallën a masën e rrjedhimit të veprimit në fjalinë drejtuese.Të tilla janë lidhëzat: që, sa, saqë, aq sa, kështu që.

10.Lidhëza kundërvënëse(opozicionale)janë ato që shërbejnë për të ndërtuar fjali të varura kundërvënëse, d.m.th. që tregojnë një kundërvënie në krahasim me veprimin a gjëndjen e shprehur në fjalinë drejtuese.Të tilla janë:në, vend që,në, nëse, në qoftë se, dhe ndërsa.

11.Lidhëza sqaruese a shpjeguese janë ato që përbëjnë një grup më vete të lidhëzave, të cilat shërbejnë për të lidhur bnjë fjali ose gjymtyrë fjalie, duke sqaruar a saktësuar kuptimin e një fjalie a të një gjymtyre tjetër.Të tilla janë lidhëzat:domethënë,(d.m.th), për shembull(p.sh), bie fjala(b.f) etj.²²

²² SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq..221,222

KREU IV

1.4. Pjesëza

Pjesëza i takon klasës së fjalëve të pandryshueshme dhe si fjalë shërbyese përdoret për të shprehur ngjyrimet kuptimore plotësuese të një fjale të veçantë, të një togfjalëshi a të një fjalie të tërë, duke përcaktuar qëndrimin e folësit, përkatësisht anën emocionale të të folurit si dhe për të ndërtuar disa forma gramatikore. P.sh.: Mos nëno, e ndaloi përsëri e reja, nuk bën të shkelim atje tek na zbuam, se kushedi ç' do të thonë.

Pjesëzat janë të ngjashme me parafjalët dhe lidhëzat në disa veçori: ato janë fjalë shërbyese, u mungon kuptimi leksikor, nuk janë gjymtyrë me vete të fjalisë dhe nuk kanë tregues të veçantë gramatikorë²³.

²³ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq..223

1. 4.1. Klasifikimi i pjesësive sipas strukturës

Sipas strukturës përkatësisht ndërtimit morfologjik, pjesëzat ndahen në: pjesëza fjalë të thjeshta, pjesëza fjalë të përngjitura dhe pjesëza lokucione.

Pjesëzat fjalë të thjeshta janë të pazbërthyeshme nga pikëpamja e strukturës, si, :s', nuk, ja, jo, po, de, pa, le, gjë, vallë, të. Do. Për, u, duke, etj.

-Pjesëzat fjalë të përngjitura janë ato që janë formuar me përngjitje e dy e më shumë fjalëve në një fjalë(pjesëz)të vetme. Të tilla janë pjesëzat :kushedi .thuajse(pothuajse),posi, porsa, sikur, sapo, veçse etj.

-Pjesëzat lokucione janë ato që përbëjnë një shprehje pjesëzore, përkatësisht që përbëhen nga dy e më shumë fjalë të veçuara, por që japin një pjesëz, si p.sh:po se po, po që po, jo se jo, jo që jo, sa që, ja që, se mos, e po, vetëm sa, vetëm e vetëm etj²⁴.

²⁴ SHLP Gjuha e sotme shqipe Gjakovë 1998.fq..224

1.4.2. Klasifikimi i pjesëzave sipas kuptimit(domethënies)

Sipas kuptimit që shprehin pjesëzat i ndajmë në këto katër grupe:1) pjesëza që shprehin ngjyime të ndryshme kuptimore; 2) pjesëza që shprehin qëndrimin e folësit; 3) pjesëza emocionale-shprehëse; 4) pjesëza formante.

1.Pjesëzat që shprehin ngjyime të ndryshme kuptimore. Në këtë grup bëjnë pjesë pjesëzat që shprehin ngjyime kuptimore plotësuese të një fjale, një togfjalish a të një fjalie.Sipas ngjyimeve kuptimore që shprehin, pjesëzat e këtij grupi ndahen në:Pjesëza dëftuese, pjesëza përcaktësuese, pjesëza përforcuese dhe pjesëza përfruese.

- Pjesëzat dëftuese janë ja dhe qe ,të cilat përdoren zakonisht për të treguar frymorin a sendin që ndodhet(ose është i njohur) përpara bashkëbiseduesit, për t'ia tërhequr vëmendjen atij .P.sh.:Ja, Vita që gjer dje futej në dhe për t'ëmëm, sot po i ngjitej kodrës, për të ngarkuar gurë për varrin e saj.Qe, Besa, njashtu...u hodh Zejnepja. Qe ku pot a them;

-Pjesëza përkatësuese janë:*pikërisht, mu tamam, plot, rrumbullak, po, sapo, porsa, sa, që, qysh, deri a gjer e ndonje tjetër, të cilat e saktësojnë më mirë kuptimin e një fjale, togfjalësh a të një fjalie.*Pjesëzat pikërisht, mu, tamam, bash zakonisht vjen përpara një fjale togfjalëshi a fjalie për të përcaktuar më mirë një rrethanë vendore, kohore ose një mënyrë veprimi.P.sh.:pikërisht këtu, në qytetin e gurtë, përpara reklamave të kinemasë, rrinin në këmbë, duke ndjekur me sy kalimtarët, ca ushtarë italianë.

Pjesëza plot, rrumbullak vihen përpara numërorëve të mirfilltë. P.sh.:Rrumbullak dy orë qëndrova në shtëpinë e shokut.

Pjesëzat po, sapo, porsa, sa, që, qysh, përsaktësojnë rrjedhimin e veprimit të emërtuar nga folja.P.sh.:turma po largohej drejtë qendrës.Njertzit po iknin.

Pjesëzat porsa a posa, sapo zakonisht këto vihen përpara formave gramatikore të foljes në një rreth nga nëndarjet e kohës së shkuar të mënyrës dëftore me përjashtim të së pakryerës.

P.sh.:Margarita porsa(posa) doli nga shtëpia!

Pjesëzat që, qysh, deri a gjer përdoren përpara ndajfoljeve, togjeve emërore me parafjalë për të treguar pikënisjen në kohë e në hapësirë.P.sh.:Sami Frashëri filloi të shkruajë që në rini.

-Pjesëzat përforcuese shërbejnë për të porforcuar a për të nxjerrë në pah më mirë kuptimin e një fjale, të një togfjalëshi ose të një fjalie përkatësisht për ta veçuar a kufizuar atë.Meqë shprehin ngjyime të shumta kuptimore, këto pjesëza mund ti ndajmë në këto ²⁵

nën grupe:pjesëza përforcuese-kufizuese,pjesëza përforcuese-shtuese, pjesëza përforcuese-thirrëse.

²⁵ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998...fq.224,225

a)Pjesëza përforcuese-kufizuese janë:sidomos, veçanërisht, vetëm, veç, veçse, të cilat shërbejnë për të kufizuar, a veçuar kuptimin e një fjale, të një togfjalëshi a të një fjali.P.sh:.dua vetëm kafe tha musafiri.Ai kishte mbaruar veç shkollën fillore.

b)Pjesëzat përforcuese shtuese janë:dhe, edhe, madje, bile,as të cilat shprehin ngjyrimë kuptimore shtuese, dukeu vënë përpara një fjale, togfjalëshi a fjalie.P.sh:.Dhe lindi një jetë e re te ne.Madje nuk dihej asgjë edhe për jetën e tyre.

ç)Pjesëzat përforcuese-thirrëse janë:o, or, ore, more, oj,ori, moj, mori, të cilat përdoren për të përforcuar thirrjen kur drejtohem dikuj (me emra në funksion thirrori)P.sh:.Puna e mbarë, o djalë; O nëna ime,prit pak or burrë.

-Pjesëzat perafuese janë:afër, nja, si nja, gati, gati-gati, aty-aty, sa,gati sa, rreth, desh, mend e ndonjë tjetër të cilat përdoren zakonisht përpara togfjalëshave për ta paraqitur kuptimin e tyre në menyre të përafërt P.sh:.Bariu plak ruante kopenë me nja treqind kokë dele.

2.Pjesëzat që shprehin qëndrimin e folësit.Në këtë grup përfshihen pjesëzat, të cilat shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv.Këtu hyjnë pjesëzat:pohuese, mohuese, dyshuese, pyetëse dhe zbutëse.

-Pjesëzat pohuese janë:po se po, si urdhëron etj.Folësi këto i përdor për të pohuar mendimin e shprehur nga dikush tjetër, a për ta miratuar atë.P.sh:.Po, po ta thotë usta koqi ty.Posi,ka njerëz të tillë;tha kamerieri.

-Pjesëzat dyshuese janë:ndoshta,mbase,kushedi,vallë, sikur, shprehin dyshimin e folësit lidhur me veprimet, ngjarjet a dukuritë që kanë ndodhur a do të ndodhen.p.sh:.Kush e di ç'kuptojnë njerëzit.Ai sikur u kënaq me këtë.

-Pjesëzat pyetëse janë: u, ë, e, të cilat përdoren në fjali pyetëse sidomos në fillim të saj, për të theksuar më mirë pyetjen, por edhe në fund,për të shprehur ngjyrimë kuptimore habije jeronie, a zemërimi.P.sh:.Nuk paske, a?.E si thoni nisemi?

3.Pjesëzat emocionale-shprehese në këtë grup bëjnë pjesë pjesëzat të cilat shërbejnë për të shprehur ngjyrimë të përjetimevë psikike ose për të shtuar fuqinë shprehëse të të folurit.Të tilla janë: te, pra, q'pa, se.P.sh:E po, mjaft, de tha Linda gjithë zemërim. Lëre de!

4.Pjesëzat formante në këtë grup bëjnë pjesë pjesëzat të cilat shërbejnë për të ndërtuar format e ndryshme gramatikore (analitike) të tilla janë: pjesëzat : u, të, do, duke,pa,për, më.P.sh:U dashkam të lahem jo vetëm ti pastroj duart²⁶.

²⁶ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq 227,228

KREU V

1.5. Psthirrma

Psthirrma i takon klasës së fjalëve të pandryshueshme dhe përdoret për ta shprehur gjendjen shpirtërore të folësit si dhe për t'ia tërhequr vëmendjen dëgjuesit. P.sh.: Eh, pucelli! Ta dish sa ë dua! Me anë të psthirmës Eh, shprehim dhembje, hidhërim, keqardhje, pendim e ndonjë ndjenjë tjetër. Psthirrma more përdoret kur i drejtohem një personi të gjinisë mashkullore ose e thërrasim një burrë a një djalë (disa). Psthirrat më qafsh, Të keqën, aman, shprehin nxitje, lutje. Ndërsa psthirrat bububu, qyqja shprehin frikë, pikëllim, keqardhje etj.

Psthirrat mund të jenë tinguj, fjalë ose shprehje frazeologjike, të cilat shprehin ndjenjat e folësit, përkatësisht folësi me to ia tërheq vëmendjen dëgjuesit lidhur me veprimet, ngjarjet a dukuritë e realitetit tonë.

Psthirrat nuk bëjnë pjesë as në grupin e fjalëve shërbyese, megjithëse disa prej tyre afrohen mjaft me to, sidomos me pjesëzat emocionale-shprehëse. Si pjesë të pandryshueshme të ligjeratës ato nuk kanë asnjë kategori gramatikore. Në strukturën e tyre ato nuk kanë parashtesa e prapashtesa.

Meqë janë karakteristike për gjuhën e folur, psthirrat kuptohen më drejt në ligjërim, kur ky shoqërohet me intonacion përkatës ose edhe me mimikë të caktuar. Në këtë mënyrë mund të qartësohet a të përcaktohet më mirë përmbajtja, përkatësisht kuptimi i psthirmave, si p.sh. i psthirmës eh, e cila mund të shprehë ngjyrimë të ndryshme të ndjenjave: të dhimbjes (eh ç' të gjëti të shkretin!) të keqardhjes (eh, si s' e vura re!) të pendimit (eh, ç' bëra!) të habitjes (eh, ti qenke!) të dëshirës (eh, sikur të kthehej sonte!) etj.²⁷.

²⁷ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..fq..231,232

1.5.1. Klasifikimi i pasthirmave

Pasthirrat si kategori leksiko-gramatikore dallohen nga pjesët e tjera të ligjëratës, jo vetëm nga veçoritë gramatikore por edhe nga prejardhja e tyre. Kështu, p.sh., edhe një fonemë e vetme mund të jetë pasthirmë: -A !-E!...-O!, që zakonisht nuk ndodh me pjesët e tjera të ligjëratës.

Pasthirrat nga prejardhja mund ti klasifikojmë në dy grupe: pasthirra të parme dhe pasthirra jo të parme.

-Pasthirrat e parme janë ato që nuk kanë dalë nga pjesët e tjera të ligjëratës, përkatësisht që janë formuar nga tinguj të veçantë zanorë, me përsëritjen e tyre, me kombinime të zanoreve ose me kombinim të bashkëtingëllorëve me zanore etj. P.sh.: A, sa e bukur qenka; E, kush na erdhi;

-Pasthirrat jo të parme janë ato që fonohen nga pjesët e tjera të ligjëratës duke humbur veçoritë e mëparshme gramatikore dhe duke marrë veçori karakteristike për pasthirrat. P.sh.: Forca, djem;

Si pasthirra jo të parme në gjuhën shqipe po përdoren edhe ato që kanë burim të huaj, si: alo, aman, hajt, hajde, marsh, urra, bravo etj.²⁸

²⁸ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998..faqe.233

1.5.2. Klasifikimi pasthirmave sipas kuptimit

Nga pikëpamja kuptimore pasthirrat mund t'i klasifikojmë në: pasthirra emocionale, pasthirra nxitëse dhe pasthirra përshëndetëse.

1. Pathirrat emocionale janë ato që shprehin ndjenja të ndryshme të folësit ose gjendjen emocionale të tij lidhur ngushtë me realitetin tonë. Ndjenjat që shprehen me anë të këtyre pasthirmave sjellin kënaqësi ose pakënaqësi. Pikërisht nga kjo pikëpamje pasthirrat e këtij grupi do të ndajmë në dy nën grupe²⁹. a) pasthirrat që sjellin kënaqësi dhe b) pasthirra që sjellin pakënaqësi.

a) pasthirrat që sjellin kënaqësi janë ato që shprehin gëzim, ngazëllim, hare, admirim etj. Të tilla janë pasthirrat: Ah, aha, eh, o, oh, oho etj. Ja disa shembuj: Ah, sa i lumtur jam; Oh, sa mirë që erdhët; sa mirë qenka kështu.

b) pasthirrat që sjellin pakënaqësi janë ato që shprehin: frikë, tmerr, hidhërim, mërzi, përbuzje etj. Në këtë nën grup përfshihen më shumë pasthirra si të parme, ashtu edhe jo të parme, si: a, ehe, ehu, oho, o bobo, ububu, kuku, qyqja, korba, e zeza etj. Ja disa shembuj me këto pasthirra: a, në të zënça; ah, sa më dhemb koka; aha s'na doli gjë.

2. Pasthirrat nxitëse janë ato që shprehin vullnetin a dëshirën e folësit në formë thirrjeje, lutjeje a grishjeje. Sipas ngjyimeve kuptimore që shprehin këto pasthirra mund ti klasifikojmë në dy nën grupe: a) pasthirra thirrëse dhe b) pasthirra shtytëse.

a) pasthirra thirrëse janë ato që folësi i përdor si thirrje për t'ia zgjuar kureshtjen a për t'ia tërhequr vëmendjen dikuj. Të tilla janë pasthirrat: alo, ej, hej, o, (përdoren për të dy gjinitë), or, ore, mor, more, (vetëm për gjininë mashkullore), moj ori, mori, (vetëm për gjininë femërore) p.sh.: a je ti, shok doçtor, ej, ti, ku shkon? ej, fëllënzë e malit.

b) Pasthirrat shtytëse janë ato që folësi i përdor si thirrje nxitëse, si lutje a grishje, por edhe si urdhër për ta përfunduar një punë a një veprim sa më parë ose mund të shprehin edhe ngjyime të tjera kuptimore të këtij karakteri. Të tilla janë pasthirrat: forca, oburra, të keqën, të lumtë, bravo, hop a hopa, aman, urra, shët, etj. P.sh.: Forca shok ë, se edhe pak na mbeti. Oburra bjerni armikut; 3. Pasthirrat përshëndetëse janë ato më të cilat përshëndesim, mirënjohim a urojmë njerëzit në shenjë nderimi a mirësjellje. Të tilla janë pasthirrat: faleminderit, lamtumirë, ditën e mirë, natën e mirë etj. Ja disa shembuj: Më treguat gjëra shumë interesante. Faleminderit shoqe; etj.

²⁹ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998.fq.235,236

1.5.3. Tingullimitimet(onomatopetë)

Në klasën e pasthirmave zakonisht përfshihen edhe fjalët tingullimituese,d.m.th. ato fjalë që janë formuar nga bashkimi i tingujve të ligjëritimit, që pasqyrojnë përafërsisht zërin a zhurmën e kafshëve, të sendeve e të dukurive të realitetit objektive.Këto fjalë, që për nga përbërja tingullore ngjajnë me pasthirrat, ndryshojnë dukshëm nga ato, meqë nuk shprehin gjendjen shpirtërore të folësit, por shërbejnë për imitim a riprodhimin e tingujve, të zërave a të zhurmës së frymorëve, të sendeve a të dukurive të natyrës në mënyrë sa më besnike.Duke pasur parasysh faktin se imitimi a riprodhimi i zërit a i zhurmës së sendit të dhënë varet nga të përceptuarit dhe ndjenja e imituesit , shpesh kemi tingullimitime të ndryshme për një veprim të caktuar.Kështu, p.sh., për të qeshurit kemi disa tingullimitimesh:-Ha-ha! Ha-ha!-qeshte padashur Afërdita.-Ho-ho-hoo!-u dëgjua qeshja e ngjirur e një plaku.Nga një grup të rinjesh u dëgjua qeshja:-Hi-hi-hiii!³⁰

Në shumicën e rasteve tingullimitimet në gjuhën shqipe kanë forma(përbërje tingullore) të përcaktuar për veprime a dukuri të dhëna, si p.sh.: -Ha-ha-ha! Ha-ha-ha!-qeshin sorkadhet(vajzat)e lëndinës duke hedhur vallen dhe tak-tak u rreth zemra.-Be-bee! Be-bee!-blegërinë disa dele dhe u matën ti shkonin nga prapa dashi.

³⁰ SHLP Gjuha e sotme shqipe 1 Gjakovë 1998. Fq. 237

KREU IV

1.6. PARAFJALA

Parafjala është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që shpreh marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, një numërori ose një përemri në një rastë të caktuar dhe një gjymtyre tjetër në një togfjalësh, p.sh.:luaj me top; e njoha nga të folurit; rreshtohuni për dy; udhëtim rreth botës; i shpejtë në punë i dashur me të gjithë, larg nga qyteti etj.

Në këta shembuj shihet se fjala prej së cilës varet gjymtyra me parafjalë, mund të jetë folje, emër, mbiemër, përemër, numëror, ose ndajfolje, po rënë pjesën më të madhe të rasteve parafjalët lidhin një emër me një folje.

Në raste të veçanta parafjalët përdoren edhe para disa ndajfoljesh,p.sh.:u nis për këtu ose për atje; e dua për sivjet, jo për mot;për më vonë; për kur e do? Për ku je nisur?për këtë për andej etj.Këto janë kryesisht ndajfoljet përemrore ku, kur, nga, ashtu, kështu, këtej, andej të cilat kanë një kuptim të afërt me përemrat, si edhe disa ndajfolje të tjera, që, në këto raste , nga kuptimi, paraqiten të afërta me emrat , p.sh.:për mirë “për të mirë”, për keq”për të keq”, për nesër “për ditën e nesërme” ose si emërtime të një rrethane, p.sh.:nga brenda jashtë, nga jashtë brenda, nga poshtë lart, nga lart poshtë;për mot, për sivjet.

Ndonjë parafjalë mund të përdoret edhe para mbiemrave(me kuptim kufizues),p.sh.:Për i mirë, i mirë është. Për trim se kishte shokun.Për të përforcuar ose saktësuar kuptimin, përdoren herë-herë edhe dy parafjalë së bashku:për nga ,p.sh.:Ç’u nise për në shtëpi...Janë të ndryshëm për nga pasha dhe përmasat. Të tilla togje mund të ruajnë vlerën e dy parafjalëve të njëpasnjëshme ose të përbëjnë lokucione.³¹

Si fjalë shërbyese, parafjalët kanë kuptim leksikor të kushtëzuar, nuk mund të përdoren me vete, prandaj nuk mund të jenë as gjymtyrë fjalie, por përbëjnë një gjymtyrë të vëtmë më fjalën që vjen pas tyre.Kuptimi i parafjalëve sqarohet, konkretizohet brenda togfjalëshit dhe varet si nga kuptimi i gjymtyrës së përcaktuese,para së cilës rri parafjala, edhe nga kuptimi i gjymtyrës së përcaktuar prej saj, khs, p.sh.:sheshi buçiti nga këngët këngët dhe zëri i tij buçiti nga tribuna; ose punon për shoqërinë dhe mëndon për shoqërinë.Të dy shembujt e parë gjymtyrë kryesore është folja buçiti, por në varësi nga kuptimi i gjymtyrës së varur këngët, tribuna parafjala nga mund të shprehë marrëdhënie shkakore ose vendore; te dy shembujt e tjerë gjymtyra e varur është po ajo, shoqërinë, por në varësi nga kuptimi i gjymtyrës kryesore parafjala për mund të shprehë marrëdhënie qëllimore ose kundrinore.

³¹ ASHSH,Grup autorësh,Gramatika e gjuhës shqipe 1,Tiranë,2002..fq.381

Megjithatë, nuk duhet menduar se parafjalët janë të zhveshura krejtësisht nga kuptimi leksikor. Te parafjalët e prejardhura prej fjalësh emërtuese (ndajfolje, emra), si: drejt, larg, anës, rreth etj., ky kuptim është më i qartë, por edhe parafjalët e parme, si: në, me, për, pa, mbi, nën etj., ky kuptim është më i qartë, por edhe parafjalët e parme, si: në, me, për, pa, mbi, nën etj., kanë një kuptim leksikor më pak a më shumë të përgjithshëm, edhe po të vështrohen jashtë togfjalëshit. është pikërisht ky kuptim që përçakton lidhjet e një parafjale me këto ose ato fjalë emërtuese.

Parafjalët përdoren kryesisht me rasat e zhdrejta :me kallëzoren, rrjedhoren e gjinoren. Në gjuhën shqipe parafjalët zakonisht përdorën me një rasë të caktuar, me përjashtim të ndaj e për që përdoren me nga dy rasa, ato e zgjerojnë semantikën e përgjithshme të këtyre rasave dhe u japin mundësi që të shprehin kuptime sa më të veçanta. P.sh. forma e rrjedhores malit (doli malit) tregon vend, por në një mënyrë tepër të përgjithshme. Duke u bashkuar me parafjalë, si: prej, prapa, përtej, afër, rrezë etj., ajo shpreh një varg kuptimesh më të veçanta. Keto kuptime nuk i shpreh vetem parafjala, po krejt togu i formuar nga parafjala së bashku me formën rasore. Në gjuhën shqipe, mëqenëse sistemi i mbaresave të emrit është thjeshtuar mjaft dhe forma rasash të ndryshme shpesh paraqiten njësoj, parafjalët luajnë një rol të rëndësishëm për të shprehur shumë lloje marrëdhëniesh sintaksore.

Gjatë zhvillimit të gjuhës shqipe numri i parafjalëve ka ardhur duke u shtuar, veçanërisht lokucionet parafjalore. Përdorimi i gjër i parafjalëve ka shtuar tiparet analitike të sistemit gramatikor të shqipes së sotme letrare.³²

³² ASHSH, Grup autorësh Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë, 2002. fq. 382

1.6.1. Klasifikimi i parafjalëve sipas prejardhjes

Shumica e parafjalëve nuk janë të parme por kanë dalë prej pjesësh të tjera të ligjëratës, kryesisht prej ndajfoljesh a prej emrash. Pra, nga pikëpamja e prejardhjes, parafjalët mund t'i ndajmë në: a) të parme, b) jo të parme. Parafjalë të parme janë: mbi, me, më, ndaj, ndër, në, nën, pa, prej, te(k). Parafjalë jo të parme janë ato që janë formuar me konversion nga pjesë të tjera të ligjëratës, si :afër, larg, rreth etj.

Ka edhe disa parafjalë të përngjitura të formuara nga bashkimi i dy parafjalëve, si p.sh.: përmbi, nëpër, përveç ose nga bashkimi i lidhëzës si me parafjalët, pas, mbas,; sipas, simbas.

Për parafjalët e parme është karakteristike se kanë një pasuri të madhe kuptimesh. Më shumë kuptime kanë parafjalët për, në, prej, me, po edhe të tjerat përdoren zakonisht me më shumë se një kuptim. Kuptimet e këtyre parafjalëve, janë deri diku të përgjithshme, ato konkretizohen brenda togfjalëshit.

Parafjalët jo të parme ruajnë lidhje kuptimore të qarta me fjalët emëruese, prej të cilave kanë dalë. Duke i parë sipas pjesës së ligjëratës nga e cila janë formuar, parafjalët jo të parme ndahen në dy grupe kryesore: Parafjalë ndajfoljore dhe parafjalë emërore.³³

1. Parafjalë ndajfoljore. Ndërmjet parafjalëve dhe ndajfoljeve ka lidhje shumë të ngushta. Një numër ndajfoljesh (të thjeshta, të përngjitura, ose lokucione) përdoren edhe si parafjalë, p.sh.: afër, anëmbanë, anës, brenda, drejt, gjatë, jashtë, këtej, krahas, larg, matanë, ndanë, nga, para, pas, përballë, përbri, përkrah, përmes, përpara, përreth, përsipër, poshtë, pranë, rreth, rrotull tutje, veç etj.

Përdoren si parafjalë edhe një numër lokucionesh ndajfoljore të formuara prej fjalësh me kuptim pak a shumë të afërt ose sinonimik, si: anë e përçark, anë e çark, rreth e rrotull, rreth e çark, ballë për ballë etj. Të gjitha këto parafjalë ndajfoljore përdoren me rasën rrjedhore.

2. Parafjalët emërore. Përveç emrave që janë shndërruar në parafjalë, pasi janë bërë më parë ndajfolje, si p.sh.: rreth, rrotull ka edhe disa emra të tjerë që janë bërë parafjalë drejtëpërdrejt, pa kaluar nëpërmjet kategorisë së ndajfoljes. Këta janë : anë, ballë, bri, buzë, faqe, majë, mes, midis etj.

³³ ASHSH, Grup autorësh Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë, 2002.. fq.385

Parafjalët emërore të mësipërme shprehin që të gjitha marrëdhënie vendore: anës lumit, ballë shtëpisë, bri meje, rrëzë malit, maje bregut, mes fushës, etj.

Pjesa më e madhe e parafjalëve emërore paraqiten në formë lokucioneve të formuara në këtë mënyrë:

a) Parafjalë+emër. Duke i rënditur sipas parafjalës që kanë në ballë, lokucionet më të përdorshme të këtij tipi janë: me anë, me përjashtim, me rastin, në bazë, në drejtim, në këmbë, në mes, në sajë, në vend, nga shkaku, për arsye, për hir, për punë, për shkak etj.

Lokucionet e përgjithshme përdoren me rasën gjinore, sepse kanë dalë nga gjymtyura e parë e një togfjalëshi emër+emër në gjinore, por katër prej tyre përdoren edhe me rrjedhoren, p.sh: me anë kursesh, në bazë fshati, në mes dy zjarresh, për punë inati.

b) Parafjalë+emër+parafjalë. Te lokucionet e këtij tipi parafjala e parë është kurdoherë në, e dyta kurdoherë me : në krahasim me, në kundërshtim me, në lidhje me, në pajtim me, në përputhje me etj. Të gjitha këto lokucione, meqenëse kanë si element të fundit parafjalën me, përdoren në rasën kallëzore. Kuptimet e lokucioneve parafjalore të këtij tipi varen nga kuptimet e emrave që kanë në përbërjen e tyre. P.sh.: parafjalët për arsye, nga shkaku, për shkak, nga puna, për punë shprehin marrëdhënie shkakore, lokucionet parafjalore në drejtim, në mes shprehin marrëdhënie vendore ose kufizim.

Pra, ndryshe nga parafjalët ndajfoljore, që shprehin kryesisht marrëdhënie vendore, sepse vijnë prej ndajfoljesh vendi, parafjalët emërore shprehin një rreth më të gjerë marrëdhëniesh, që zakonisht janë marrëdhënie abstrakte.

Përveç parafjalëve të përmendura deri këtu ka edhe tri parafjalë të tjera emërore, të formuara nga përngjitja e një parafjale me një emër: ndërmjet (ndër+mjet), nëpërmjet (nëpër+mjet) nëpërmes (nëpër+mes). Të trija këto përdoren në rasën rrjedhore.

Sot formimi i lokucioneve parafjalore prej emrash është rruga kryesore për pasurimin e klasës së parafjalëve.³⁴

³⁴ ASHSH, Grup autorësh Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë, 2002 fq. 386

Lokucionet e ndryshme parafjalore nuk paraqiten të gjitha njësoj nga shkalla e bashkimit të elementeve të tyre përbërëse në një njësi të vetme .Disa janë më ta gramatikalizuara, p.sh.,ato që janë formuar nga një ndajfolje dhe një parafjalë ose nga një parafjalë dhe një emër(bashkë me shokët, me anë shokësh), disa janë më pak të gramatikalizuara.Megjithatë, një lokucion parafjalor dallohet nga një bashkim sintaksor i lirë me po atë ndërtim, sepse:

a)Ka një lidhje kuptimore më të ngushtë ndërmjet elementeve të tij përbërëse:zakonisht emri që bën pjesë në lokucione të tilla, e humbet kuptimin e tij leksikor si fjalë emërtuese dhe merr një kuptim abstract e shumë të përgjithshëm.P.sh.:te lokucionet me anë, në bazë, në vend, fjalët anë, bazë, vend, nuk kanë më kuptimin leksikor dhe funksionin shënues të një emri:p.sh.:kjo çështje do të zgjidhet në bazë të ligjeve, dhe në bazë të ligjeve tona qëndron...(emër).

b)Si pasojë e dobësimit të kuptimit konkret leksikor të fjalës emërtuese të lokucionit, ajo nuk përbën me një gjymtyrë të pavarur fjalie, por formon një gjymtyrë të vetme me fjalën ndjekëse:për shkak të shiut, në pajtim me udhëzimet .

ç)emri ose një fjalë tjetër shënuese, që bën pjesë në lokucion, si rregull, nuk mund të marrë një fjalë tjetër përcaktuese;në rast të kundërt në vend të lokucionit do të kishim një lidhje të lirë sintaksore fjalësh,p.sh:në kundërshtim me, por :Burokratizmi është një formë të mënduari dhe të vepruari në kundërshtim të hapur me popullin.

ç)Trajta e emrit që bën pjesë në lokucion, si rregull, është e pandryshueshme.

Ajo është zakonisht e pashquar, me përjashtim të lokucioneve të ndërtuara me parafjalën nga, pas së cilës emri vihet rregullisht në trajtën e shquar:nga ana, nga shkak, nga puna.

Të katra këto karakteristika të lokucioneve parafjalore, të marra së bashku, i bëjnë ato që nga pikëpamja kuptimore të funksionojnë si një fjalë, ndërsa nga pikëpamja leksiko-gramatikore të merrën si një pjesë e ligjeratës.

3.Parafjalë foljore.E tillë është parafjala falë, që përdoret me rasën rrjedhore, p.sh.:Falë ndihmës së shokëve, falë teje.Ajo ka dalë nga pjesorja e foljes falem³⁵.

³⁵ ASHSH,Grup autorësh Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë,2002,fq..387.388

1.6.2. Klasifikimi i parafjalëve sipas strukturës morfologjike

Parafjalët morfologjikisht mund të jenë fjalë të thjeshta të përngjitura ose lokucione.

Janë fjalë të thjeshta të gjitha parafjalët e parme: mbi, me, më, ndaj, në, nën, pa, për, prej, te(k), një numër parafjalësh jo të parme, të formuara me konversion prej ndajfoljesh e emrash të thjeshtë, p.sh.: afër, Brenda, gjatë, jashtë, kundër, larg, lart, para, pas, veç, bri, buzë, majë, mes, faqe etj.

Janë fjalë të përngjitura parafjalët e formuara nga përngjitja e dy fjalëve të veçanta, si: nëpër, përmbi, përveç, sipas, ndërmjet, nëpërmjeksi edhe ato që janë formuar me konversion prej ndajfoljesh të përngjitura, si: matanë, përballë, përbri, përkrah, përmes, përpara, përreth etj.

Janë lokucione të gjitha parafjalët që përbëhen prej dy a më shumë fjalëve të veçanta, d.m.th. ato që janë formuar me konversion prej lokucioneve ndajfoljore, si: ballë për ballë, rreth e qark, rreth e rrotull etj, si edhe ato që kanë dalë nga togjet ndajfolje+parafjalë, parafjalë+emër, parafjalë+emër+parafjalë, si: bashkë me, tok me, me përrishtëm, në bazë, për arsye, në kundërshtim me, në lidhje me etj.³⁶

³⁶ ASHSH, Grup autorësh Gramatika e gjuhës shqipe 1 Tiranë 2002. fq.388

1.6.3. Klasifikimi i parafjalëve sipas kriterit sintaksor dhe kuptimet kryesore të tyre

.Përshkrimi i hollësishëm i kuptimeve të parafjalëve është detyrë e sintaksës.Megjithatë, për të pasur një ide më të plotë për këtë pjesë të ligjëratës, më poshtë jepen të grupuara sipas rasave parafjalët kryesore të gjuhës së sotme letrare.

1.Parafjalët e rasës emërore.Me rasën emërore përdoren parafjalët nga dhe te(k).

a)Gjymtyra e prirë nga parafjala nga mund të tregojë:

-vend(më shpesh vendin nga niset një vëprim e më rrallë vendin për ku drejtohet një veprim, ku gjendet një send a ndodh diçka, vendin a sendin prej të cilit largohet dikush a diçka, prejardhjen etj.)p.sh.:Nga bjeshkët e veriut, me lulen e trimave, Lekë Dukagjini rendi në ndihmë të vëllezërve . etj.

b)Gjymtyra e prirë nga parafjala te(që para zanoreve përdoret zakonisht në variantin tek) tregon vendin ku ndodhet a ku bëhet diçka ose sendin a njeriun drejt të cilit shkon një levizje a veprim p.sh:Afërdita, ftyrëqeshur, qëndron një copë herë të pragu i shkollës.Çdo verë shkonte të gjyshi në fshat.

2.Parafjalët e rasës gjinore.Me rasën gjinore përdoren lokucione parafjalore me anë, me anën, në drejtim, për punë, në sajë, për shkak e të tjera.

a)Gjymtyra e prirë nga parafjala me anë, me anën tregon mjet:p.sh: Kjo çështje u la të zgjidhej me anë të bisedimeve ndërmjet zëvendësministrave.Afrimi i armikut njoftohej me anën e zjarreve.

b)Parafjala në drejtim përdoret zakonisht në stilin e publicistikës me kuptim synimi e kufizimi,p.sh.:Aeroplani u kthye në drejtim të detit dhe humbi në kaltërsi.

c)Gjymtyra e prirë nga parafjala në sajë tregon në përgjithësi shkakun a mjetin që bën të mundur kryerjen e një pune, ose mënyrën, p.sh.:Forcat e armatosura të lidhjes mbaheshin në sajë të ndihmave të mëdha në të holla e ushqime që jepte vullnetarisht popullsia.

ç)Gjymtyra e prirë nga parafjala në vend tregon zëvendësim, këmbim: Eja me mua se të kam në vend të vëllait.³⁷

³⁷ ASHSH,grup autorësh,Gramatika e gjuhës shqipe 1,Tiranë 2002..fq.390

d)Parafjalët për arsye dhe për shkak tregojnë shkak dhe mund të merren si sinonime, por kuptimi i shkakut është më i fortë tek e dyta, që ka përbërjen e saj vetë fjalën shkak, p.sh.:Prodhimi i enërgjisë elektrike pati rënie të ndjeshme për arsye të mungesës së reshjeve.Ja, dëgjo të të këndojo disa vargje të një poezie të bukur, që më ka mbetur përgjysmë, për shkak të largimit tënd.³⁸

3.Parafjalët e rasës kallëzore.Kallëzorja është rasa me të çilën përdoren më shumë parafjalë të thjeshta.Parafjalët kryesore me të çilat ndërtohet kallëzorja, janë:në, më, për, pa, më, mbi, nën, ndër, nëpër.etj.


a)Lirinë e kishit kudo në krahëror, në ballë, në shpat dhe në ushtat.

Tri ditë rresht kuzhinieri na gatoi mish me fasule.

4.Parafjalët e rasës rrjedhore.Parafjalët që përdoren në rasën rrjedhore janë parafjalët e parme:prej, ndaj e për (për vetëm përpara emrave që emërtojnë pjesë të trupit të frymorëve), Parafjalët emërore:buzë, rrëzë, bri, majë, faqe etj.dhe parafjalët ndajfoljore:pranë, afër, larg, para, përpara, pas, prapa, poshtë, lart, sipër, jashtë, Brenda, drejt, gjatë, matanë, përkrah, anëmbanë, rreth e rrotull etj.

Parafjalët emërore dhe ndajfoljore, që përdoren me rasën rrjedhore, në pjesën më të madhe shprehin arrëdhënie vendore p.sh.: Rruga dredhonte rrëzë shpatave të thikta.

³⁸ ASHSH,grup autorësh Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë 2002..fq..391



Ismail Kadare lindi më 1936 në Gjirokastrë, ku përfundoi edhe arsimin e mesëm; më 1958 mbaroi degën e gjuhës e të letërsisë në Universitetin e Tiranës. Më pas shkoi në Moskë me studime për dy vjet në Institutin "Gorki". Është poet dhe prozator, dhe një nga përfaqësuesit më të shquar të letërsisë shqiptare. Rrugën e krijimtarisë letrare e nisi si poet që në vitet e gjimnazit, por u bë i njohur sidomos me vëllimin 'Shekulli im' (1961), që u pasua nga vëllimet e tjera poetike, si: 'Përse mendohen këto male' (1964), 'Motive me diell' (1968) dhe 'Koha' (1976). Vepra më e shquar poetike e Kadesës është poema liriko-epike 'Përse mendohen këto male' (1964) një pasqyrim i përgjithësuar artistik i rrugës dhe fatit historik të popullit shqiptar dhe të Partisë së Punës së Shqipërisë. Vepra poetike e Ismail Kadesës shquhet për idetë e thella dhe për figuracionin e pasur e origjinal; rol me rëndësi për pasurimin e poezisë shqiptare. Në fushën e prozës, Ismail Kadare ka lëvruar tregimin, novelën dhe romanin. Prozën e tij e karakterizojnë përgjithësimet e gjëra historiko-filozofike, subjekti i ngjeshur dhe mendimi i thellë i shprehur shpesh me anë të parabolës, mbi bazën e asociacionit apo të analogjive historike. Ideja e romanit 'Gjenerali i ushtrisë së vdekur' (1964) është shpirti liridashës i popullit shqiptar. Temën e shpirtit të pamposhtur të shqiptarëve nëpër shekuj autori e trajtoi edhe në romanin 'Kështjella' (1975). Në romanin 'Kronikë në gur' (1970) Kadare kritikoi psikologjinë provinciale dhe traditat prapanike. Probleme të rëndësishme të historisë janë trajtuar edhe në përmbledhjet me tregime e novela 'Emblema e dikurshme' (1977), 'Ura me tri harqe' (1978) dhe 'Gjakftohtësia' (1980). E veçanta e talentit të Ismail Kadesës shfaqet sidomos në trajtimin, nga një këndvështrim i ri, i temës historike dhe në tingëllimin e mprehtë aktual që është i aftë t'i japë asaj.

Një nga krijimet më të shquara të Ismail Kadare së dhe të të gjithë letërsisë së re shqiptare është romani 'Dimri i madh'

(1977). Veprat më të mira të Ismail Kadaresë janë përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe janë pritur shumë mirë nga publiku lexues. Ismail Kadare Libri që botoi Kadare në vitin 2006 "Identiteti evropian i shqiptarëve - sprovë" pjesë e të cilit u botuan edhe nga gazeta Shekulli ka shkaktuar një polemikë në mes të tij dhe Rexhep Qosjes. Kështu përderisa Kadare e karakterizon identitetin shqiptarë si perëndimorë, Qosja në librin e tij të quajtur "Realiteti i shpërfillur", thotë se identiteti shqiptar është një miks i atij perëndimor dhe lindor, krishterë dhe mysliman.

Shembuj me parafjalë të nxjerrë nga vepra “Darka e gabuar” e I.Kadaresë

Parafjalët e rasës emërore.

- 1.Italia kishte rënë në gjuhë, ushtria gjermane po përparonte **nga** jugu. (DG,10)
2. Hetuesit, **nga** padurimi, ndërprisnin njëri-tjetrin. (DG,174)
- 3..**Nga** gryka e Tepelenës era frynte përherë e më armiqësore. (DG,33)
- 4.U duk se, më në fund, qyteti po çlirohej **nga** ankthi. (DG,50)
- 5.**Nga** të gjitha hamendjet ndodhi ajo më e keqja. (DG,20)

Parafjalët e rasës gjinore.

- 1.**Për shkak** të pabesisë së tij, qyteti do të ndëshkohej. (DG,20)
- 2.**Për shkak** të mungesës së dhëmbëvë, fjalët e tij kanë qenë krejt të turbullta. (DG,198)
- 3.**Me anë** të një miku arrita ta kapërcej kufirin. (DG,39)
- 4.Italia **për shkak** të kapitullimit të befasishëm, e humbi aleatin e saj. (DG,10)
- 5.Puna jonë mbeti në gjysmë **për shkak** të largimit tënd. (DG,129)

Parafjalët e rasës kallëzore.

- 1.Ai përmendi portat **mbi** të cilat po trokitej tani, ndërsa ata po hanin darkë. (DG,52)
- 2.Gjithçka është si **në** mjegull. (DG,64)
- 3.Pasi uleshin në kafene, lexonin prapë gazetat, **nën** tingujt e muzikës. (DG,74)
- 4.Na fal **për** gabimin, doktor, tha me zë të qetë. (DG,89)
- 5.Ka qenë një **ndër** pengjet që u liruan atë natë. (DG,146)

Parafjalët e rasës rrjedhore.

- 1.**Sipas** tyre, Zjarmia e tepërt lidhej me shumë me Rusinë se me Shqipërinë. (DG,19)
- 2.Sytë i shkonin padashur te flamuri **sipër** bashkisë. (DG,88)
- 3.Unë të ftoj për darkë në shtëpinë time, **sipas** kodit që kemi folur. (DG,110)
- 4.Sytë e çelët si **prej** kukulle të rusit vështronin të qeshur. (DG,23)
- 5.**Ndaj** tij u morën masa të rrepta. (DG,66)

Literatura

- ASHSH,IGJL,Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë,2002
- ASHSH,IGJL.Grup autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë,2002
- SHLP, Musa Nushi,Gjuha e sotme shqipe 1, Gjakovë, 1998.
- Ismail Kadare, “Darka e gabuar”, Prishtinë, 2005.
- WWW.Ismail Kadare.com; Faqe zyrtare e autorit në internet.

Përfundim

Në këtë punim është paraqitur Parafjala që është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës. Kam hulumtuar nga tekste të ndryshme gjuhësore, kurse si bazë për këtë studim më ka shërbyer Gramatika e gjuhës shqipe I së bashku me veprën “Darka e gabuar” të shkrimtarit tonë të shquar Ismail Kadare. Fillimisht e kam hulumtuar materialin e pastaj i kam klasifikuar dhe sistemuar mirë kam marrë shembuj nga më të ndryshmit .Jam munduar në mënyrë sa më të mirë që të shpjegoj se parafjala qëndron para emrave, përemrave, numërorëve dhe ndajfoljeve duke vendosur marrëdhënie varësie ndërmjet fjalëve. Gjatë realizimit të temës kam përmendur edhe llojet e parafjalëve dhe klasifikimin e tyre nëpër rase.

Kam marrë edhe material të tjera për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe dallimin në mes tyre. Gjatë punës sime në këtë temë në analizimin e parafjalëve të rasës emërore, gjinore, kallëzore, dhe rrjedhore kam arritur që ti identifikoj dhe nxjerr ca shembuj nga romani :“Darka e gabuar” e Ismail Kadaresë duke i pasqyruar në këtë punim.

Jetëshkrim



Unë jam Agnesa Gjota nga Juniku kam lindur në Gjakovë më 7.4.1994.Shkollën fillore e kam kryer në shkollën fillore “Edmond Hoxha” në Junik.

Shkollën e mesme e kam kryer në”Hysni Zajmi” Gjakovë, drejtimi:Mami, kurse fakultetin në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani” dega:Gjuhë shqipe.